

Vendim nr. 47 datë 28.02.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Sonila Bejtja,	Anëtare
Fiona Papajorgji,	Anëtare

në datën 28.02.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 2 (Gj) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: **GJELINE PLANAJ**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 247, datë 28.10.2021 të Gjykatës së Apelit Shkodër; nr. 00-2022-1273, datë 25.10.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: Nenet 18, 41, 42, 115, pika 2, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 2, 6 dhe 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datën 03.08.2020 kërkesja Gjeline Planaj ka paraqitur një kallëzim penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë kundër vëllait të saj Gj. Ç. me pretendimin se ai ka falsifikuar firmën e saj në një prokurë të posaçme (nr. 937 rep., nr. 347 kol., datë 19.03.2010), duke përfutur kompensimin e dhënë nga shteti për një tokë truall. Kjo

prokurori ka regjistruar procedimin penal nr. 619 të vitit 2020 për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal (KP).

2. Në kuadër të veprimeve hetimore nga ana e organit të akuzës është kryer ekspertimi grafik i shkrimit dhe i nënshkrimit në dokumentin e prokurës së posaçme, për të cilën kërkuesja ngrinte pretendimet për falsifikim, në përfundim të të cilit është provuar fakti se shkrimi emër mbiemër (Gjeline Planaj) dhe nënshkrimi (firma) janë shkruar dhe nënshkruar nga kërkuesja. Në vijim është administruar një dokument noterial “Revokim prokure” (datë 04.08.2020), me anë të të cilit kërkuesja ka kryer revokimin e prokurës së parë. Në këto kushte, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë ka arritur në konkluzionin se ndodhej para elementeve të figurës së veprës penale “Kallëzimi i rremë”, të parashikuar nga neni 305 i KP-së, duke vendosur dërgimin e çështjes në ngarkim të kërkueses në gjyq dhe pushimin e hetimeve për veprën penale "Falsifikimi i dokumenteve", të parashikuar nga neni 186 i KP-së.

3. Me vendimin nr. 463, datë 26.07.2021, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka vendosur pushimin e çështjes në ngarkim të kërkueses për veprën penale të parashikuar nga neni 305 i KP-së dhe kthimin e çështjes për plotësimin e hetimeve në lidhje me veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, sipas përcaktimeve në pjesën arsyetuese. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim prokuroria.

4. Me vendimin nr.247, datë 28.10.2021, Gjykata e Apelit Shkodër ka vendosur: *“Ndryshimin e vendimit nr.463, datë 26.07.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë në këtë mënyrë: Dërgimin në gjyq të procedimit penal nr. 619 të vitit 2020 të Prokurorisë së Rrethit Lezhë regjistruar ndaj të pandehurës Gjeline Planaj e akuzuar për kryerjen e veprës penale të "Kallëzim i rremë", parashikuar nga neni 305 i Kodit Penal. Pushimin e hetimeve ndaj të pandehurës Gjeline Planaj për veprën penale "Falsifikimi i dokumenteve", parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal.”.*

5. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-1273, datë 25.10.2022 ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkueses, me argumentin se nuk përmban asnjë nga shkaqet që parashikohen në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

6. Në datën 16.01.2023 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore sipas objektit, si të papajtueshme me Kushtetutën.

II

Pretendimet e kërkueses

7. *Kërkuesja*, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet e kundërshtuara i kanë cenuar:

- 7.1. *Standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit në dy drejtime. Së pari, vendimi i Gjykatës së Apelit Shkodër ka kontradikta të hapura, veçanërisht në fund të arsytimit dhe dispozitivit, kur shprehet se vendos pushimin e hetimeve ndaj kërkueses për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186 i KP-së. Ky disponim është tërësisht i pambështetur, pasi ndaj saj nuk janë ngritur ndonjëherë akuza për kryerjen e kësaj vepre penale. Megjithëse në brendësi gjykata e apelit analizon mungesën e përgjegjësisë penale të të kallëzuarit, në dispozitiv shprehet se vendos pushimin e hetimeve ndaj kërkueses. Kjo gjykatë shprehet se nuk është provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm që i kallëzuari të ketë kryer veprën penale dhe në përfundim vendos pushimin e hetimeve, me argumentin se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Gjykata e Apelit Shkodër, megjithëse prokuroria nuk ka kryer asnjë hetim, ka arritur të krijojë bindjen se i kallëzuari nuk ka kryer jo vetëm veprën penale të falsifikimit të dokumenteve, por asnjë vepër tjetër penale. Së dyti, Gjykata e Lartë nuk ka marrë në shqyrtim dhe nuk i ka kthyer përgjigje pretendimeve të kërkueses për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor nga Gjykata e Apelit Shkodër. Pretendimet e paraqitura në rekurs janë për çështje ligji dhe jo për vlerësim të provave, pasi ato kanë pasur qëllim të tregojnë se prokuroria nuk ka hetuar për veprimet që ka kryer i kallëzuari me pronat në bashkëpronësi. Gjykata e Lartë nuk i ka kthyer përgjigje pretendimit se prokura e përdorur si shkak për pushimin e hetimeve nuk ka lidhje me tjetërsimin e paligjshëm të pronave në bashkëpronësi që ka kryer i kallëzuari shumë kohë përpara nënshkrimit të saj.*
- 7.2. *Parimin e barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit, pasi Gjykata e Lartë, në rastin konkret, i ka trajtuar shkaqet e rekursit si çështje fakti, ndërkohë që në çështje të ngjashme ka bërë interpretim të ndryshëm të këtyre shkaqeve.*
- 7.3. *Të drejtën e pronës, të parashikuar në nenin 41 të Kushtetutës, pasi kërkuesja, megjithëse ka qenë bashkëpronare në disa pasuri të paluajtshme të trashëguara nga prindërit, ajo nuk ka pasur asnjë përfitim, pasi ato janë tjetërsuar nga vëllai i saj.*

III Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitetin e kërkueses

8. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

9. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimin kushtetues.

10. Kolegji vlerëson se kërkuuesja legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në ankimin kushtetues, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për çështjen e parashtruar.

11. Lidhur me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata në praktikën e saj ka pranuar se, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, individ mund t’i drejtohet asaj për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shterur të gjitha mjetet juridike efektive. Shterimi i mjeteve juridike efektive nënkupton që ankuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Shterimi i mjeteve juridike efektive përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuuesi, i cili para se t’i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se i ka përdorur të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura (*shih vendimet nr. 10, datë 04.03.2021; nr. 38, datë 25.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkuuesja i është drejtuar Gjykatës për kundërshtimin e vendimit nr. 00-2022-1273, datë 25.10.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, në të cilin është vendosur mospranimi i rekursit të saj kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër, që ka vendosur pushimin e hetimeve për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve” si dhe dërgimin e çështjes në gjyq në ngarkim të saj për veprën penale “Kallëzim i rremë”. Kërkuuesja në kërkesën drejtuar Gjykatës specifikon se kundërshton procesin gjyqësor të zhvilluar në gjykatën e apelit dhe Gjykatën e Lartë vetëm për pjesën e vendimit të prokurorit

për pushimin e hetimeve për kallëzimin që ajo ka bërë kundër vëllait të saj për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”. Në këtë kuptim, Kolegji çmon se kërkesja nuk ka mjete të tjera për të shteruar përpara se t’i drejtohet Gjykatës dhe, për rrjedhojë, ajo e plotëson edhe këtë kriter.

13. Në lidhje me legjitimitimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në rastin konkret, vendimi më i fundit i kundërshtuar nga kërkesja mban datën 25.10.2022, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 16.01.2023. Për rrjedhojë, kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor të lartpërmendur, pra përmbush edhe kriterin e legjitimitimit *ratione temporis*.

14. Për sa i takon legjitimitimit *ratione materiae*, kërkesja ka pretenduar cenimin e parimit të barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit, referuar vendimmarrjeve të tjera të Gjykatës së Lartë në raste të ngjashme.

15. Gjykata, nën dritën e parimit kushtetues të barazisë para ligjit, të sanksionuar nga neni 18 i Kushtetutës, ka pohuar se barazia para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjlojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Kjo presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta. Megjithatë, parimi i barazisë nuk e ndalon trajtimin e diferencuar, por trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë mund të përligjet vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive (shih vendimet nr. 34, datë 10.04.2017; nr. 60, datë 16.09.2016; nr. 71, datë 27.11.2015 të Gjykatës Kushtetuese).

16. Në kuptim të sa më sipër, Kolegji thekson se mënyra e zgjidhjes së çështjes dhe e zbatimit të ligjit është e drejtë e çdo gjykatë, sepse çdo çështje konkrete është specifike dhe ka individualitetin e saj, e harmonizuar me rrethana, faktorë, motive ose prova gjyqësore, të cilat nuk mund të jenë të njëjlojta. Për më tepër, në çështjen në shqyrtim, konstatohet se argumentet e kërkeses për këtë pretendim kanë të bëjnë me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit nga Gjykata e Lartë. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se ajo nuk ka arritur ta ngrejë atë në nivel kushtetues.

17. Për sa i përket pretendimit për cenimin e së drejtës së pronës, sipas nenit 41 të Kushtetutës, Kolegji, duke mbajtur në konsideratë se argumentet lidhen me procesin ligjor gjyqësor të zhvilluar ndaj kërkeses, çmon ta analizojë çështjen e paraqitur në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, sipas të cilit prona nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pronës, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë.

18. Për sa më lart, për të përcaktuar nëse kërkueses i është cenuar e drejta e pronës, është e rëndësishme të analizohet në themel nëse procesi ligjor i zhvilluar nga gjykatat, të cilat kanë dhënë vendimet që kundërshtohen prej saj, ka përmbushur standardet e procesit të rregullt në këndvështrim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, i cili *prima facie*, përfshihet në kompetencën e kësaj Gjykate.

B. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit

19. Kërkuesja ka pretenduar cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit nga ana e Gjykatës së Apelit Shkodër dhe Gjykatës së Lartë. Më konkretisht, ajo ka pretenduar se vendimi i gjykatës së apelit ka kontradikta të hapura, veçanërisht në fund të arsyetimit dhe dispozitivit, kur shprehet se vendos pushimin e hetimeve ndaj kërkueses për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186 i KP-së. Ky disponim është tërësisht i pambështetur, pasi ndaj saj nuk janë ngritur ndonjëherë akuza për kryerjen e kësaj vepre penale. Megjithëse në brendësi gjykata e apelit analizon mungesën e përgjegjësisë penale të të kallëzuarit, në dispozitiv shprehet se vendos pushimin e hetimeve ndaj kërkueses. Kjo gjykatë shprehet se nuk është provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm që i kallëzuari të ketë kryer veprën penale dhe në përfundim vendos pushimin e hetimeve, me argumentin se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Gjykata e Apelit Shkodër, megjithëse prokuroria nuk ka kryer asnjë hetim, ka arritur të krijojë bindjen se i kallëzuari nuk ka kryer jo vetëm veprën penale të falsifikimit të dokumenteve, por asnjë vepër tjetër penale. Gjykata e Lartë nuk ka marrë në shqyrtim dhe nuk i ka kthyer përgjigje pretendimeve të kërkueses për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nga Gjykata e Apelit Shkodër. Pretendimet e paraqitura në rekurs janë për çështje ligji dhe jo vlerësimi të provave, pasi ato kanë pasur qëllim të tregojnë se prokuroria nuk ka hetuar mbi veprimet që ka kryer i kallëzuari me pronat në bashkëpronësi. Gjykata e Lartë nuk i ka kthyer përgjigje pretendimit se prokura e përdorur si shkak për pushimin e hetimeve nuk ka lidhje me tjetërsimin e paligjshëm të pronave në bashkëpronësi që ka kryer i kallëzuari shumë kohë përpara nënshkrimit të saj.

20. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Gjykata ka pohuar se vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato duhet të jenë në shërbim dhe

funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, si dhe duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë (*shih vendimin nr. 23, datë 29.04.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Megjithatë, detyrimi për garantimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nuk nënkupton se kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse, por ai varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimet nr. 80, datë 18.12.2017; nr. 34, datë 13.06.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë drejtim, zbatimi i standardit të arsyetimit të vendimit është vlerësuar nga Gjykata, rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre (*shih vendimet nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 71, datë 30.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Në rastin konkret, Kolegji vëren se Gjykata e Apelit Shkodër, pasi ka marrë në shqyrtim ankimin e prokurorit, ka arritur në përfundimin se i kallëzuari nuk e ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, duke e gjetur të drejtë pushimin e hetimit për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”. Kërkuesja në rekursin e ushtruar ndaj vendimit të gjykatës së apelit, ndër të tjera, ka pretenduar edhe cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit nga ajo gjykatë, pretendime këto të cilat janë pasqyruar edhe në vendimin e Gjykatës së Lartë (*shih faqet 10-11 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

23. Gjykata është shprehur se jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt, në aspektin e shkeljes së të drejtave kushtetuese, dhe se ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit (*shih vendimet nr. 38, datë 02.12.2021; nr. 71, datë 13.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjatë shqyrtimit të pretendimeve për të drejtën për proces të rregullt ligjor nuk mjafton vetëm konstatimi i shkeljes procedurale, por duhet të analizohet karakteri i saj, pasojat që kanë ardhur për kërkuesin dhe për interesat që ai përfaqëson (*shih vendimin nr. 38, datë 02.12.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Në këtë vështrim, për sa i përket pretendimit se standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor është cenuar në drejtim të faktit se në dispozitivin e vendimit Gjykata e Apelit Shkodër është shprehur “...Pushimin e hetimeve ndaj të pandehurës Gjeline Planaj për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal”, Kolegji vlerëson se ai përbën një gabim material, pasi në tërësi në vendim analizohen shkaqet e pushimit të hetimit ndaj të kallëzuarit për kryerjen e kësaj vepre penale. Për më tepër, kërkuesja, pavarësisht se ka pasur mundësinë e ndreqjes së gabimit material, nuk ka paraqitur kërkesë për të kërkuar korrigjimin e vendimit nga Gjykata e Apelit Shkodër.

25. Kërkuesja ka pretenduar se edhe Gjykata e Apelit Shkodër është shprehur se nuk është provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm që i kallëzuari të ketë kryer veprën penale dhe në përfundim ka vendosur pushimin e hetimeve me argumentin se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Gjithashtu, kjo gjykatë, megjithëse prokuroria nuk ka kryer asnjë hetim, ka arritur të krijojë bindjen se i kallëzuari nuk ka kryer jo vetëm veprën penale të falsifikimit të dokumenteve, por asnjë vepër tjetër penale.

26. Gjykata ka theksuar se ajo e vlerëson arsyetimin e një vendimi gjyqësor vetëm në kuadër të përmbushjes ose jo të standardeve të mësipërme, pasi nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit, sikurse pretendon edhe kërkuesi në rastin konkret. Kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Në aspektin e kontrollit kushtetues, Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimet nr. 16, datë 16.03.2021; nr.12, datë 19.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Në rastin në fjalë, Kolegji çmon se pretendimet e kërkueses nuk kanë të bëjnë me cenimin e parimeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, por me mënyrën e interpretimit të ligjit, konkretisht të dispozitave që lidhen me KP-në dhe KPP-në, të cilat hyjnë në juridiksionin e gjykatave të zakonshme dhe jo të atij kushtetues. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se nuk rezulton që gjykata e apelit të mos ketë respektuar standardin e arsyetimit të vendimit.

28. Ndërsa në lidhje me pretendimet për cenimin e këtij standardi nga vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, Kolegji konstaton se ky i fundit ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesja, me argumentin se nuk përmban asnjë nga shkaqet që parashikohen në nenin 432 të KPP-së. Ky kolegji ka arsyetuar, ndër të tjera, se pjesa e pretendimeve të ngritura në rekurs që ngre çështje të vlerësimit të provave, të cilat në rastin konkret lidhet me vlerësimin nëse vendimi i prokurorisë për pushimin e çështjes është i drejtë ose jo (*të shqyrtuara nga gjykatat e faktit, në zbatim të nenit 152 të KPP-së*), del jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë (*shih paragrafin 30 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

29. Po kështu, në ndryshim nga sa pretendon kërkuesja, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë i ka kthyer përgjigje pretendimeve të saj se prokuroria në kërkesën për pushimin e çështjes nuk i ka trajtuar të gjithë elementët e parashtruar në kallëzim, duke argumentuar se *“ky pretendim nuk është i bazuar pasi rezulton e qartë që kallëzuesja ka lëshuar prokurë të posaçme në vitin 2010, prokurë e cila i është nënshtruar aktit të ekspertimit grafik ku ka rezultuar se është shkrimi dhe nënshkrimi i saj”*. Gjithashtu, edhe në lidhje me pretendimin se nuk është kryer hetim tërësor për të gjitha veprimet që mund të ketë kryer i kallëzuari në

ZVRPP Lezhë, pasi dyshohet se mund të ketë vijuar vjedhjen me anë të mashtrimit të pronave, të përfituara me vendimin nr. 65, datë 18.05.1995 të KKKP-së, Lezhë, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë është shprehur se në përmbajtje të prokurës që është objekt kallëzimi, *“kallëzuesja Gjeline Planaj, e ka autorizuar të kallëzuarin/përfaqësuesin Gjelosh Çetaj që "...të kryej veprime edhe me vetveten duke e tjetërsuar këtë pronë në emër dhe pronësi të vet". Për sa kohë prokura është e vlefshme, përmbajtja e saj nuk mund të jetë objekt hetimi të mëtejshëm nga ana e prokurorisë. Prandaj edhe ky pretendim në lidhje me mashtrimin për tjetërsim të pronave që burojnë nga vendimi KKKP, nuk është i bazuar pasi me prokurën objekt kallëzimi, kallëzuesja i ka kaluar të gjitha të drejtat për tjetërsimin e këtyre pronave, duke mos gjetur asnjë paligjshmëri në veprimet që mund të ketë kryer apo tentuar të ketë kryer i kallëzuari në mbështetje të tagrave të kaluara.”* (shih paragrafët 31 dhe 32 të vendimit të Gjykatës së Lartë).

30. Nga sa më lart, duke qenë se vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë në pjesën hyrëse përmban palët, bazën ligjore, rrethanat e çështjes, vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta, si dhe ka marrë në shqyrtim dhe i ka dhënë përgjigje shteruese pretendimeve të ngritura nga kërkuesja për shkaqet e parashtruara në rekurs, Kolegji vlerëson se nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit.

31. Në përfundim, Kolegji çmon se pretendimi i kërkueses për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, përfshirë edhe të drejtën e pronës, e analizuar në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, është haptazi i pabazuar. Për rrjedhojë, kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.